



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

NJOFTIM

Për Shtesë Në Rendin E Ditës Në Mbledhjen e Radhës

Në mbështetje të nenit 53, pika 2, të nenit 57 pika 2/c të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 48, nenit 49 , neni 55 pika 5, të Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, Këshilli Bashkiak Durrës,

NJOFTON:

DITËN E HËNË DATË 26.07.2021, ORA 12:00, NË MBLEDHJEN E RRADHËS QË DO TË MBAJ KËSHILLI BASHKIAK, DO TË KEMI SHTESA, ME KËRKESË TË BASHKISË Durrës, NË RENDIN E DITËS SI MË POSHTË:

****	MIRATIMI I SHTESAVE TË RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
Pika 8. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 3, 5, 6, BASHKIA Durrës, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 9. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT, BANORË TË 4 PALLATEVE NË LAGJEN NR.17, RRUGA "AHMET DAKLI", PALLATI NR.15, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

<p>Pika 10. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit</p>	<p>MBI MIRATIMIN PËR PRISHJEN E DETYRUAR TË NDËRTESESË, TË SHKOLLËS SË MESME “DHOSI LIPERI”, QË MBAN NR. 4, TË LISTËS, QË ME VKM NR. 297, DATË 28.4.2010, KA KALUAR NË PRONËSI TË BASHKISË SUKTH (SOT BASHKIA DURRËS), PËR SHKAK SE ËSHTË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E DATËS 26 NËNTOR 2019 DHE STRUKTURA E OBJEKTIT NË GJENDJEN EKZISTUESE NUK I PLOTËSON KUSHTET E SIGURISË DHE QËNDRUESHMËRISË PËR NJË VEND SIZMIK SIÇ ËSHTË DURRËSI, KJO SIPAS AKTEKSPERTIZËS SË REALIZUAR NGA SHOQËRIA “ARKIMADE SHPK”, I KONFIRMUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT DHE MIRATIMIN PËR HEQJEN NGA KONTABILITETI DHE LISTA PARAPRAKE TË PRONAVE, TË SHKOLLËS SË MESME “DHOSI LIPERI”, QË MBAN NR. 4 TË LISTËS SË TRANFERIMIT, ME VENDODHJE NË QENDËR SUKTH, NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH, QË ME VKM NR. 297, DATË 28.4.2010, BËN PJESË NË LISTËN PARAPRAKE TË PRONAVE TË BASHKISË SUKTH (SOT BASHKIA DURRËS)</p>
--	--

Komisionet, që do të shqyrtojnë projektvendimet do të jenë:

Në mbështetje të nenit 33, neni 34/1, neni 77 /8, të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak Durrës, anëtarët e Komisioneve të Këshillit Bashkiak pasi shqyrtojnë me njëri tjetrin projektvendimin përkatës, dërgojnë me email propozimin e tyre (RAPORTIN) mbi projektvendimin, sipas grafikut të mëposhtëm.

DATA 25.07.2021 Pikat 8, 9 do të shqyrtohen nga:

- Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike
 - Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike
- dhe dërgojnë me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës 20.00.

DATA 25.07.2021 Pika 10, do të shqyrtohet nga:

- Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor
 - Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës
 - Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike
- dhe dërgojnë me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës 20.30

SEKRETARE KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS

Dorina Milja